

**LIGJI Nr. 04/L-046  
PËR RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi dhe fushëveprimi**

Ky ligj rregullon themelimin, funksionimin dhe kompetencat për Radiotelevizionin e Kosovës, me qëllim të sigurimit të informimit të saktë, objektiv, të paanshëm dhe të shpejtë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

**1.1.Shërbim medial audiovizuel** - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i të cilit është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojë, argëtojë apo edukojë gjithë publikun, përmes rrjetave të komunikimeve elektronike. Një ofrues i tillë i shërbimeve mediale audiovizuele është transmetues televiziv apo video me kërkesë.

**1.2.Ofrues i shërbimit medial** - personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuele të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.

**1.3.Transmetim** - emetim burimor i programit me valë difuzive nëpërmjet të transmetuesit tokësor, rrjetit kabllor, transmetimit digjital, satelitor ose me pajisje të tjera elektronike, të koduar apo të pakoduar, që i destinohen për shfrytëzim publikut, që pranohen me radio, televizion ose pajisje elektronike të veçanta për emetim, duke mos përfshirë komunikimet individuale;

**1.4.Transmetues** - personi juridik, që ka përgjegjësi redaktuese për përbërjen e shërbimeve programore televizive dhe të radios për pranim nga publiku i përgjithshëm dhe që i transmeton ato apo bën që ato të transmetohen të tëra e të pandryshuara nga pala e tretë.

**1.5.Transmetim televiziv** - një shërbim media audiovizuel linear i ofruar nga ofruesi i shërbimit medial për shikim të njëkohshëm të programeve, në bazë të një orari të caktuar të programit.

1.6. **Operator i rrjetit** - personi juridik i cili ofron çfarëdo forme të rrjetit për transmetim të programeve ose një shërbim transmetimi për publikun, posedimin dhe korrespondimin e licencave ose autorizimin e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Media.

1.7. **Digjitalizim** procesi i kalimit nga transmetim analog i programeve në atë digjital/numerik.

1.8. **Përgjegjësi redaktuese** – ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe mjeteve për ushtrimin e kontrollit efektiv dhe efikas mbi përzgjedhjen dhe organizimin e tyre në radhitje kronologjike në rastin e transmetimit televiziv ose në katalog në rastin e shërbimit medial audiovizuel në bazë të kërkesës.

1.9. **Plan i frekuencave të transmetimit** - plani i frekuencave të radiotransmetimit ose të transmetimit televiziv, të caktuara nga Komisioni i Pavarur për Media dhe që menaxhohet nga ky Komision.

1.10. **Komunikim komercial audiovizuel** - tablotë me dhe pa zë, të cilat janë prodhuar me qëllim të promovimit të drejtpërdrejt ose të tërthortë të mallrave-produkteve, shërbimeve apo të tablove të tjera të një subjekti fizik ose juridik i cili zhvillon aktivitet të ligjshëm dhe legal ekonomik. Tablotë e tilla përfshihen në programet audio-vizuale të transmetuesit publik, kundrejt një pagese përkatëse, me qëllim të promovimit të produkteve apo shërbimeve përkatëse, që janë objekt i komunikimit komercial audiovizuel. Këto forma të komunikimit ndër të tjera përfshijnë: reklammat televizive, sponsorimet, teleshopingun (teletregtimin) dhe vendosjen e produkteve.

1.11. **Reklamim** - çfarëdo shpallje publike e transmetuar me pagesë apo kompensim të ngjashëm, për qëllime të vetë-promovimit; që është i destinuar për promovimin e shitjes, blerjes apo qiradhënies së një prodhimi apo shërbimi; për ta shtyrë përpara ndonjë ide apo çështje, ose për të shkaktuar disa efekte tjera të dëshiruara nga reklamuesi apo nga vet transmetuesi.

1.12. **Transmetues publik** - personi fizik apo juridik-organizatë mediale publike elektronike, që ka përgjegjësi redaktuese për ofrimin e shërbimeve të programit radio-televiziv për praninë nga publiku i gjerë, dhe i transmeton ato vet apo i transmetohen përmes një pale të tretë, në mënyrë të lirshme, profesionale, të pavarur, në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

1.13. **Agjent për inkasim të shumës së parapagimit për RTK-** personi juridik i regjistruar i cili kryen shërbime të inkasimit për nevojat e Radiotelevizionit të Kosovës.

1.14. **KPM** - Komisionin e Pavarur të Mediave siç është përcaktuar në ligjin përkatës.

1.15. **Pagesë për RTK-** tarifa e cila duhet të paguhet nga ekonomitë familjare dhe personat juridik për marrje të transmetimeve nga Radiotelevizioni i Kosovës në pajtueshmëri me këtë ligj.

1.16. **Sponsorim** - kontribut i ndonjë ndërmarrje publike ose private ose personi fizik që nuk është i angazhuar në veprimtaritë transmetuese apo në produksionin e veprave audio-vizuale, në financimin direkt apo indirekt të ndonjë programi, por që synon promovimin e emrit, shenjës, imazhit apo aktiviteteve të atij personi.

1.17. **Veprat Audiovizuale Evropiane** - veprat krijuese, produksionet apo bashkëproduksionet të cilat kontrollohen nga personat fizik apo juridik të Evropës.

1.18. **Kanal** - një përmbajtje e frekuencave tokësore, që bartë një skemë të definuar të programeve, brenda për brenda Radiotelevizionit publik të Kosovës dhe selisë së tij.

1.19.**Program** - përmbajtja që transmetohet nga një kanal i caktuar audio-vizual i transmetuesit publik.

1.20.**Komunitet** - banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës.

1.21.**Teleshoping** - transmetimin e ofertave direkte për publikun, me qëllim të furnizimit të mallrave apo shërbimeve, përfshirë pronën e paluajtshme, të drejtat dhe obligimet, në kundërshtim të pagesës.

## **KREU II RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS**

### **Neni 3 Radiotelevizioni i Kosovës**

1. Radiotelevizioni i Kosovës (në tekstin e mëtejme RTK) është transmetues publik i Kosovës.
2. RTK është person juridik jo profitabil me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme i cili ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore.
3. RTK ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues.

### **Neni 4 Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës.
2. Kuvendi mbron autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së të përcaktuar me këtë ligj.

### **Neni 5 Selia e Radiotelevizionit të Kosovës**

Selia e Radiotelevizionit të Kosovës është në Prishtinë.

### **Neni 6 Prona e Radiotelevizionit të Kosovës**

Çështja e pronës së RTK-së rregullohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Kosovës në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

## **KREU III PARIMET PROGRAMORE TË RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS**

### **Neni 7 Obligimet e RTK-së në lidhje me përmbajtjen, kanalet dhe shërbimet**

1. Obligimet e shërbimit publik të RTK-së në lidhje me përmbajtjen, kanalet dhe shërbimet që ofron ai në mënyrë të veçantë duhet të përfshijnë si vijon:

- 1.1. promovimin e kulturës së dialogut qytetar dhe ofrimin e një arene të gjerë për diskutim publik;

1.2. ofrimin e përmbajtjes me cilësi të lartë e cila ofron informata për ngjarjet në vend, në zonat ndërkufitare, në Evropë dhe në botë;

1.3. ofrimin e përmbajtjes edukative-arsimore të cilësisë së lartë;

1.4. ofrimin e përmbajtjes kulturore të cilësisë së lartë;

1.5. prodhimin e programeve të dramave;

1.6. ofrimin e prodhimeve të brendshme televizive të cilësisë së lartë për fëmijët, adoleshentët dhe të moshuarit;

1.7. ofrimin e përmbajtjes argëtuese të cilësisë së lartë për të gjitha grupmoshat;

1.8. realizimin e të drejtave kushtetuese të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera kombëtare në lidhje me ofrimin e informimit publik dhe shpërndarjen e përmbajtjes së ofruar nga RTK;

1.9. përfshirjen e arritjeve kulturore dhe arritjeve të tjera të komuniteti serb dhe të komuniteteve të tjera në kanalet e radiove kombëtare dhe përmbajtjes në televizionet kombëtare në gjuhën shqipe;

1.10. në pajtim me traktatet ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me korporatat transmetuese radiotevizive të vendeve të tjera, ofron mbështetje për krijimin dhe zhvillimin e projekteve ndërkufitare për radio, televizion dhe projekte të tjera;

1.11. ofrimin e përmbajtjes për personat me aftësi të kufizuara shqisore, duke përdorur teknologjitë e përshtatura për nevojat e tyre;

1.12. vëmendje e veçantë i kushtohet personave me aftësi të kufizuara sa i përket programeve dhe ofrimit të informatave;

1.13. vëmendje të veçantë do t'i kushtohet fëmijëve dhe familjes;

1.14. paraqitja dhe promovimi i kulturës së Kosovës, kreativitetit kulturor dhe lirisë së shprehjes artistike;

1.15. paraqitjen dhe promovimin e shkencës;

1.16. vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pozitës shoqërore dhe aktiviteteve të komuniteteve të regjistruara fetare;

1.17. vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet historisë dhe identitetit të Kosovës dhe vendit të saj në arenën ndërkombëtare, dhe promovimit të bashkëpunimit universal, mirëkuptimit dhe njohjes së historive, kulturave dhe identiteteve;

1.18. promovimin e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të sportit, rekreacionit dhe mënyrës së shëndoshë të jetës;

1.19. vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përmbajtjes për shëndetësi, mbrojtje të mjedisit dhe mbrojtje të konsumatorëve;

1.20. vëmendje e veçantë do t'i kushtohet çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me sigurinë e njerëzve, mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera dhe me mbrojtjen kombëtare, përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve të bashkësisë ndërkombëtare anëtare e të cilave është Kosova, dhe ofrimi

i njoftimeve urgjente në lidhje me rreziqet për njerëzit, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;

1.21. konsideratë e duhur do t'i jepet çdo interesi të veçantë dhe legjitim të grupeve të tjera të shikuesve, dëgjuesve dhe shfrytëzuesve të tjerë të përmbajtjes së ofruar nga RTK në ndonjë formë ose përmes ndonjë mënyre të transmetimit ose platforme të shpërndarjes në Kosovë;

1.22. promovimin dhe, në pajtim me obligimet e detyrueshme të rrjetit të radiotelevizionit publik, duke siguruar prodhimin dhe performancën e punimeve audiovizuale lokale, punimeve audiovizuale evropiane dhe punimeve audiovizuale të producentëve të pavarur;

1.23. promovimin e produksionit të filmit Kosovar.

2. Në kuadër të strukturës së përmbajtjes, kanaleve dhe shërbimeve të ofruara nga RTK-ja si pjesë e performancës së shërbimit publik, RTK duhet t'ia kushtojë një pjesë shumë të madhe të kohës së transmetimit javor në secilin kanal apo shërbim tjetër për përmbajtjen kulturore, artistike, informative, dokumentare apo edukative/arsimore.

3. Drejtori i Përgjithshëm, një herë në vit, do të hartojë një raport mbi ofrimin e përmbajtjes kulturore, artistike, informative, dokumentare apo edukative/arsimore të cilin pastaj do t'ia paraqes Bordit të RTK-së për miratim. Nëse Bordi i RTK-së nuk e miraton ose aprovon raportin, ai do të fillojë procedurën e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm.

4. RTK do të kryej aktivitetet e veta transmetuese, do të punojë në pajtim të plotë me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe me të gjitha rregullat, rregulloret dhe dispozitat e KPM-së, përfshirë edhe Ligjin e KPM-së dhe strategjinë e KPM-së për digjitalizim. RTK do të veprojë në bazë të licencës për kanalet e autorizuara të radiotelevizionit të vet. RTK siguron dhe garanton që të ruajë dhe arkivojë në mënyrë adekuate dhe profesionale programet e saja, ashtu siç parashihet me ligj.

## **Neni 8 Përbërja, skemat e RTK-së**

1. Përbërja dhe emetueshmëria e programeve e të skemave programore të RTK-së, është diverse dhe e planifikueshme. Planifikimi bëhet në baza vjetore, mujore, javore dhe ditore.

2. RTK përfshinë:

2.1. dy (2) kanale televizive:

2.1.1. kanali televiziv në gjuhën shqipe; dhe

2.1.2. kanali televiziv në gjuhën serbe.

2.2. dy (2) kanale të radios të Kosovës.

3. Këto dy (2) kanale janë, të detyruara të ndajnë pesëmbëdhjetë përqind (15%) të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve tjera të Kosovës.

4. RTK- ofron edhe programe satelitore për kosovarët, të cilët jetojnë jashtë Kosovës.

5. RTK-ja mund të transmetojë edhe programe në gjuhët e tjera nga ato që fliten nga komunitetet e Kosovës.

6. Në përputhje me kushtet dhe mundësitë financiare, hapësinore, logjistike dhe teknike, RTK mund të zgjerojë rrjetin e tij transmetues edhe me kanale tjera duke përfshirë edhe kanalën në gjuhët e komuniteteve tjera.

7. Menaxhmenti dhe bordi i RTK-se duhet të marrë të gjithë hapat e nevojshme për të siguruar funksionimin operacional të kanalit RTK 2 në gjuhën serbe si ofrues i përmbajtjes jo me vonë së dymbëdhjetë (12) muaj nga miratimi i këtij ligji.

### **Neni 9**

#### **Detyrimet e veçanta programore të RTK-së**

1. Duke ushtruar aktivitetet dhe veprimtarinë e tij publike, RTK, sipas këtij ligji detyrohet që:

1.1. të nxis, kultivojë, avancojë, prodhojë e bashkë prodhojë të gjitha modalitetet dhe përmbajtjet e krijimtarisë audio-vizuale, të cilat i kontribuojnë zhvillimit dhe avancimit të kulturës, artit, shkencës dhe të gjitha vlerave të tjera sublimë të qytetarëve të Kosovës dhe ti afirmojë ato vlera jashtë Kosovës;

1.2. të siguroj kushte dhe mundësi për arritjet maksimale në krijimtarinë audiovizuale;

1.3. të përgatis dhe emitojë programe të tilla, që përshkohen më vlera, më të arritura profesionale dhe etike e që janë në përputhje të plotë me standardet dhe kodekset etike të gazetarisë hulumtuese, objektive, të lirë dhe të pavarur;

1.4. të kontribuojë avancimit të demokracisë, lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe të harmonisë e koekzistencës në Kosovë dhe më gjerë;

1.5. të kultivoj respektin ndaj dinjitetit, integritetit dhe privatësisë së individit; nderit dhe mirëqenies socio-ekonomike të tij/saj;

1.6. të sigurojë të drejtën e përgjigjes së qytetarëve të interesuar;

1.7. të mos transmetojë programe me intonacione, qoftë edhe diskrete dhe as dykuptimëshe, sidomos të natyrës, animit dhe karakterit propagandues politik, fetar dhe /ose etnik.

1.8. të veprojë sipas detyrimeve të përcaktuara me ligje të veçanta.

### **Neni 10**

#### **E drejta për reagim, demantim dhe sqarim**

RTK pranon, mirëpret dhe i trajton të gjitha llojet dhe modalitetet e paraqitjes së propozimeve, vërejtjeve, sugjerimeve, kritikave kreative dhe konstruktive, dhe parashtrësat e ankesat e ndryshme nga qytetarët e Kosovës. Për të gjitha lajmet, emisionet, informatat dhe produktet e tjera emituese-transmetuese, elektromagnetike dhe elektronike të plasuar nëpërmjet rrjetit radio-difuziv, RTK në përputhje me ligjin dhe kodin e sjelljes për media elektronike, secilit person fizik dhe juridik i ofron të drejtën për reagim dhe qartësim.

### **Neni 11**

#### **Shtrirja e rrjetit -transmetues**

1. RTK shtrinë, rrjedhimisht siguron rrjetin e mbulueshmërisë së plotë, të dëgjueshmërisë dhe shikueshmërisë në tërë territorin e Kosovës.

2. RTK-ja mund të shpërndajë përmbajtje nëpërmjet rrjetit tokësor analog ose digjital, satelitor, kabllovik, internetit, apo nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër të avancuar dhe të ligjshme në përputhje me standardet e BE-së.

## **Neni 12 Produksionet e pavarura**

1. RTK ka produksionin e vet burimor dhe autentik.

2. Me qëllim të realizimit të misionit, vizionit dhe objektivave të veta, drejt përmbushjes së shijeve, kërkesave, nevojave dhe interesave diverse të shikuesve dhe dëgjuesve të Kosovës, RTK për çdo vit do të shpallë konkurs publik për blerjen e veprave audiovizuele të produksioneve të pavarura, dhe t'i transmetoj në programin e vet në pajtim me Ligjin dhe Statutin e RTK-së.

3. Për hir të racionalizimit të shpenzimeve dhe ekonomizimit të punës, RTK-ja duhet të angazhohet që me burimet e saj njerëzore dhe teknike, që ka në dispozicion, të mbulojë skemën programore me sa më shumë prodhime të producentëve dhe të punonjësve në institucion.

4. RTK duhet të sigurojë së paku pesëmbëdhjetë përqind (15%) të programit të RTK-së, por jo më shumë se njëzet përqind (20%), nga producentët e pavarur vendor, në transmetimet radiotelevizive, duke përfshirë obligimet sipas nenit 9 të këtij ligji por duke mos i përfshirë këtu programet e lajmeve.

5. Emitimi i prodhimeve të pavarura që paguhet nga mjetet e RTK-së, përjashton çfarëdolloj reklame apo sponsorimi.

6. Procedurat, kushtet dhe kriteret më të hollësishme për porositjen e veprave audiovizuele dhe të tjera të përafërta nga producentët e pavarur dhe për transmetimin e tyre në pajtim me këtë ligj duhet të përcaktohen me rregullore të brendshme të harmonizuara me legjislacionin vendor.

## **Neni 13 Ngjarjet e veçanta**

Në interes të të gjithë qytetarëve, RTK siguron në mënyrë adekuate mbulimin e ngjarjeve më të rëndësishme politike, shkencore-profesionale, kulturore, zbavitëse dhe sportive (konferencat, festivalet, olimpiadat, kampionatet ndërkombëtare dhe të ngjashme) të vendit dhe jashtë tij. RTK-ja do të ketë qasje në ngjarje të tilla me qëllim që të informoj një publik sa më të gjerë që është e mundur.

## **Neni 14 Transmetimi i njoftimeve urgjente**

1. RTK-ja transmeton pa vonesë dhe pa pagesë, njoftimet dhe informatat e cilësdo natyrë dhe rast, të cilat kërkojnë urgjencë e që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin publik, me fatkeqësi elementare; me ngjarje të jashtëzakonshme, të rënda, me rrjedhoja negative e të dëmshme për popullsinë e Kosovës, ndonjë pjesë të saj apo qytetar të vetëm.

2. Njoftimet ose informacionet nga paragrafi paraprak i këtij neni, duhet të jenë të lëshuara dhe të verifikuara zyrtarisht, nga organet kompetente të nivelit qendror ose lokal të Republikës së Kosovës e në pajtueshmëri të plotë me ligjet në fuqi.

**Neni 15**  
**Transmetimi i informatave dhe programeve me përmbajtje religjioze**

1. RTK mund të transmetojë informata dhe ngjarje me përmbajtje religjioze, me kusht që këto programe të:

- 1.1. mos e portretizojnë, karakterizojnë dhe eksponojnë një religjion superior ndaj tjetrit;
- 1.2. mos shpotisë, përçmojnë dhe denigrojnë ndonjë religjion;
- 1.3. mos të ndikojë, në mënyrë të qartë e të çiltër anëtarësim në ndonjë organizatë religjioze, rrjedhimisht të mos e promovojë anëtarësimin dhe predikimin në të;
- 1.4. mos të përmbajë mesazhe të promovimit religjioz-politik.

**Neni 16**  
**Mbulimi i fushatës zgjedhore**

RTK-ja e mbulon fushatën zgjedhore, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për zgjedhjet.

**Neni 17**  
**Komunikimet komerciale**

1. Sipas këtij ligji, RTK mund të emitojë porosi publicitare, reklama dhe marketing, deri në masën që nuk e rrezikon misionin dhe vizionin zhvillimor të tij, jo më shumë se dhjetë përqind (10%) të vëllimit programor të tërësishëm. Ky limit do të rishikohet në momentin e financimit nga parapagimi në pajtim me Ligjin për KPM-në.

2. Porositë e transmetuara publicitare, duhet ti kenë të gjitha tiparet, elementet dhe karakteristikat e nevojshme ligjore dhe duhet të dallohen nga pjesët e tjera të programeve në kuptimin optik në TV dhe në kuptimin akustik në Radio.

3. Porositë publicitare nuk bënë të ndikojnë në përmbajtjen e programeve të rregullta të RTK dhe as në cenimin e pavarësisë së tij.

4. Porositë publicitare transmetohen në blloqe midis programeve të caktuara.

5. Personat përgjegjës në RTK; ata/ato që japin lajme ose prezantojnë programe me përmbajtje, nuk mund të marrin pjesë direkte dhe as të ndikojnë indirekt, në asnjë formë as mënyrë, në veprimtarinë publicitare të RTK-së.

6. Përmbajtja, vendosja e reklamave dhe programeve të sponsoruara, si dhe ndalimi i reklamimit të produkteve dhe shërbimeve që janë në dëm të shëndetit dhe rendit publik janë të rregulluara me ligje të veçanta.

**Neni 18**  
**Politika redaktuese dhe e përmbajtjeve programore**

1. Përgjegjësitë parësore të RTK-së, që burojnë nga misioni i tij i përcaktuar me këtë ligj, në mënyrë të veçantë përfshijnë.

- 1.1. përgatitjen, prodhimin dhe transmetimin e programeve të ndryshme audiovizuale për nevojat e qytetarëve të Kosovës, rajonit, diasporës dhe mbarë botës së lirë e demokratike e interesuar për ngjarjet dhe zhvillimet në Kosovë.



1.2. përgatitjen, prodhimin dhe transmetimin e programeve të veçanta, me përmbajtje specifike dhe tematike;

1.3. përforcimin, rikonstruktimin dhe ndërtimin e ri të transmetuesve radioteleviziv dhe stacioneve e nënstacioneve të ritransmetimit;

1.4. përgatitjen teknike e profesionale dhe transmetimin e shërbimeve të teletekstit;

1.5. inkorporimin e teknologjive të reja në prodhimin dhe transmetimin e programeve radiotelevizive;

1.6. përgatitjen dhe ofrimin e shërbimeve në zbatimin e veprimtarive dhe aktiviteteve komerciale-biznesore, që lidhen me prodhimin audioviziv, duke përfshirë këtu edhe eksportin dhe importin;

1.7. inkurajimin e veprimtarive programatike artistike, letrare, shkencore, kulturore dhe edukative e shëndetësore;

1.8. kultivimin e gjuhëve zyrtare dhe të gjuhëve të komuniteteve të tjera në Kosovë si dhe përhapjen e njohurive të tyre edhe jashtë vendit.

2. Programet e RTK-së nga paragrafi paraprak i këtij neni, duhet të udhëhiqen kryesisht nga:

2.1. ndjenja e përgjegjësisë, vëmendjes dhe kujdesit për përmbajtjen e mesazhit të çdo lajmi, informacioni apo të çdo fjale të transmetuar, në të mirë të mbrojtjes së emrit, autoritetit dhe reputacionit të RTK-së, si institucionit të vetëm publik në Kosovë;

2.2. të ofrojnë informacione të besueshme përkitazi me larushinë ndërlojore të ngjarjeve, rasteve, proceseve dhe dukurive që ndodhin në Kosovë dhe jashtë saj;

2.3. të inkurajojë, stimulojë dhe nxitë me korrektësi dhe profesionalizëm kulminant avancimin e vazhdueshëm të pikëpamjeve, mendimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve drejt formimit të opinionit publik; pjesëmarrjen e tyre aktive dhe kontribut dhënës në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit;

2.4. të respektoj, ta vë në pah dhe ta avancojë sistemin tradicional dhe autentik të vlerave tona dhe vlerave universale etike dhe morale të njerëzimit;

2.5. të shërbej dhe ndihmoj procesin e forcimit koheziv të familjes, solidaritetit kosovar dhe avancimin e procesit të shtet ndërtimit në Kosovë;

2.6. të kontribuojë në akceptimin e njohurive me të reja për ruajtjen e shëndetit dhe të ambientit jetësor, si dhe të vejë theks informimi në luftën institucionale dhe ligjore kundër patologjive sociale;

2.7. t'i trajtojë dhe vejë në spikamë problemet, kërkesat dhe nevojat elementare dhe vitale të qytetarëve të Kosovës, veçmas të pjesëtarëve të komuniteteve dhe grupeve me nevoja të veçanta.

3. RTK udhëheqë, zhvillon dhe kultivon politikë redaktuese me përmbajtje të shëndosha, pozitive, asnjansë, kreative, perspektive, qytetëruese, profesionale dhe humane.

4. RTK nuk do të transmetojë asnjë material, i cili me përmbajtjen, nëntekstin, dykuptimësinë, aludimin ose edhe me tonin, nxit diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet,

pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

5. RTK i respekton dhe zbaton standardet e pranuarra gjerësisht të mirësjelljes në përmbajtjen e programit apo skemës programore, duke u përkujdesur veçanërisht për mbrojtjen e zhvillimit fizik, mental dhe moral të fëmijëve, por edhe respektimin e dinjitetit, shëndetit, pozitës dhe gjendjes së grup moshave të tjera në shoqëri dhe përcjelljen e mesazheve për publikun, përmes transmetimit të programeve, reportazheve dhe modaliteteve të tjera të informimit për ta.

6. RTK kujdeset në mënyrë të veçantë, që të mos emitojë programe me përmbajtje dhe ose porosi të cilat mund të kenë përmbajtje në kundërshtim me moralin publik, jo - etik, jo - edukativ, jo - social, të pandershme, pornografike, me sjellje të panatyrshme; që propagojnë ose që ngashënjnë në dhunë, kriminalitet, dezorientim, depresion dhe në fenomene të tjera psikopatologjike dhe sociopatologjike.

7. RTK nuk do të transmetojë asnjë material, që është i pavërtetë, dezinformues, shantazhues, përgënjeshtues, përdhosë ose mashtrues apo për të cilin me një hetim rutinor dhe të arsyeshëm, do të mund të përcaktohej se është i pavërtetë, dezinformues apo mashtrues.

8. Politika redaktuese e RTK-së duhet të jetë e pavarur, korrekte, profesionale, objektive, e balancuar dhe asnjansë.

9. RTK, në suaza të skemës dhe hapësirës programore, transmeton informacione zyrtare të institucioneve shtetërore, pa vonesë dhe të pandryshuar.

10. RTK, nuk bartë përgjegjësi për përmbajtjen, rrjedhimisht saktësinë dhe origjinalitetin e informatës së emituar zyrtare.

## **Neni 19 Përmbajtja Audiovizuale Evropiane**

RTK- me punë profesionale, korrektësi ndaj dëgjuesve dhe shikuesve të vetë dhe me përkushtim permanent në zhvillimin, avancimin dhe promovimin e vlerave dhe virtyeteve të shoqërisë kosovare, në sferën e informimit elektronik, pretendon të arrijë nivelin përkatës i cili korrespondon, me standardet Evropiane për përmbajtje bashkëkohore audiovizuale, sa më shpejtë që të jetë e mundur.

## **Neni 20 Veprimtaritë e tjera**

1. Aktivitetet e RTK-së gjithashtu mund të përfshijnë:

1.1. tele-tekstin, shfrytëzimin dhe shpërndarjen përmes internetit, mediumet e reja dhe forma të tjera të komunikimit medial dhe aktivitetet tjera të komunikimit medial.

1.2. publikimi dhe distribuimi i materialeve audio, video dhe atyre të shtypura që kanë të bëjnë me programin e tij apo me transmetimin në përgjithësi;

1.3. organizimi i ngjarjeve muzikore, kulturore dhe ngjarjeve tjera;

1.4. këmbimi dhe participimi në programet e përbashkëta dhe programet tjera apo projektet teknike me agjencitë tjera transmetuese dhe prodhuesit e programeve;

1.5. blerja dhe shitja e programeve;

1.6. ruajtja dhe përdorimi i arkivave apo video dhe audio incizimet;

1.7.studimi i tregut medial dhe kryerja ose porositja e hulumtimit të audiencës dhe sondazhet e opinionit;

1.8.aktivitete tjera siç janë përcaktuar në Statut, duke u siguruar që aktivitetet e tilla nuk janë kontradiktore me aktivitetin qendror të RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj dhe me dispozitat tjera në fuqi.

## **KREU IV FINANCIMI I RTK-së**

### **Neni 21 Burimet e financimit**

1. Për zhvillimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve të saj ligjore, RTK, financohet nga:

1.1. parapagimi;

1.2. themeluesi;

1.3. nga vetëfinancimi përmes veprimtarisë së tij ekonomike;

1.4. nga burimet tjera që mund të përfshijnë:

1.4.1. kontratat me palë të treta për shërbime transmetuese, duke shfrytëzuar kapacitetet teknike në dispozicion në pajtim me ligjin;

1.4.2. shërbime të tjera programesh;

1.4.3. botimet e prodhimeve muzikore, video, audio, librave, gazetave, revistave që lidhen me programet;

1.4.4. veprimtaritë koncertale dhe shfaqjet publike;

1.4.5. reklamat dhe publikimet e mesazheve të tjera të paguara në pajtim me ligjin;

1.4.6. sponsorimet dhe donacionet në pajtim me ligjin;

1.4.7. përgatitja, prodhimi dhe shitja e programeve të RTK-së.

2. Fondet e RTK-së, duke përfshirë parapagimin për transmetuesin publik dhe burimet tjera të financimit të parapara me këtë nen, si para publike, depozitohen në një llogari të vetme zyrtare në pajtim me rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar.

3. Të gjitha fondet publike, përfshirë edhe fondet e BK-së, të pranuar nga RTK dhe të depozituara plotësisht në një llogari të vetme zyrtare në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni do të shfrytëzohen vetëm për performancën e shërbimit publik e jo për ndonjë lloj aktiviteti komercial.

4. Për një periudhë transitore, deri trevjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-së i ndahet zero pikë shtatë përqind (0.7 %) e të hyrave nga Buxheti i Kosovës duke përfshirë të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njëhershme për Buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe lokal.

4.1. çdo vit kalendarik RTK do të ndajë dhjetë përqind (10%) të buxhetit të vet të përgjithshëm të pranuar nga të gjitha burimet për Kanalin në gjuhën serbe. RTK do të

vazhdojë të ndajë dhjetë (10%) të buxhetit të vet të përgjithshëm për kanalin e dytë të RTK-së në gjuhën serbe pasi të pushojë financimi nga Buxheti i Kosovës dhe nga Themeluesi.

4.2. ndarja e dhjetë përqind (10%) të fondeve siç përcaktohet në paragrafin më lartë nga buxheti i RTK-së për kanalin e dytë të RTK-së në gjuhën serbe do të bëhet jo më vonë se një javë pas pranimit të fondeve nga Buxheti i Kosovës dhe nga themeluesi, pavarësisht mënyrës se si është marrë financimi. Dhjetë (10%) e fondeve të mbledhura nga parapagimi do t'i transferohen kanalit të dytë të RTK-së në gjuhën serbe jo më vonë se në fund të muajit kur ato pranohen. Dhjetë (10%) e të gjithë të ardhurave të tjera buxhetore të RTK-së do t'i transferohen kanalit të dytë të RTK-së në gjuhën serbe jo më vonë se në ditën e fundit të secilit muaj.

4.3. shuma prej dhjetë përqind (10%) e buxhetit të RTK-së që i transferohet kanalit të dytë të RTK-së në gjuhën serbe fillimisht do të përdoret për të filluar punën e këtij të fundit duke siguruar objektet, pajisjet e ndryshme teknike dhe pajisjet për zyrë dhe mobile për zyrë, si dhe për punësimin e stafit të duhur. Pasi RTK 2 në gjuhën serbe të jetë bërë funksional, atëherë dhjetë (10%) përqind e buxhetit të RTK-së do të përdoret për të mbuluar shpenzimet rrjedhëse për funksionimin e RTK 2 në gjuhën serbe, përfshirë edhe për prodhimin e programeve specifike në gjuhën serbe të çfarëdo lloji. Ndarja prej dhjetë përqind (10%) e fondeve nga buxheti i RTK-së për kanalin RTK 2 në gjuhën serbe nuk duhet të përdoren për asnjë qëllim tjetër përveç funksionimit administrativ, teknik, dhe redaktues të kanalit RTK 2 në gjuhën serbe.

5. Menaxhmenti i RTK-së duhet të fillojë përgatitjet për zbatimin e mekanizmit për mbledhjen e parapagimit, dhe do t'ia propozojë atë për shqyrtim të brendshëm dhe aprovim Bordit të RTK-së, jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

6. Fondet për RTK-në që vijnë nga Buxheti i Kosovës dhe nga Themeluesi do të ndahen dhe përcaktohen çdo vit pas paraqitjes së raportit vjetor për aktivitetin e RTK-së dhe aprovimin e propozimit të buxhetit për vitin pasues të hartuar nga RTK.

6.1. RTK-ja i'a dorëzon Kuvendit raportin e saj vjetor të aktiviteteve jo më vonë se 31 mars dhe propozimin e saj për buxhetin e vitit vijues jo më vonë se 30 tetor.

## **Neni 22** **Parapagimi**

1. Themeluesi me propozimin e Bordit të RTK-së duhet të vendosë për nivelin e taksës për transmetuesin publik. Taksa do të jetë fikse për periudhën të paktën tre vjet.

2. Bordi i RTK-së do t'ia propozojë Kuvendit mekanizmin për mbledhjen e tarifës së abonimit, përfshirë nivelin e tarifës, jo më vonë se dy (2) javë pas marrjes nga menaxhmenti i RTK-së. Kuvendi do ta miratojë mekanizmin për mbledhjen e tarifës së abonimit, përfshirë nivelin e tarifës, sa më parë që nga koha e pranimit nga Bordi i RTK-së, mirëpo jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj nga hyrja e ligjit të tanishëm në fuqi. Menaxhmenti i RTK-së do ta zbatojë mekanizmin për mbledhjen e tarifës së abonimit menjëherë pas miratimit nga Kuvendi.

3. Pas fillimit të mbledhjes së tarifës së abonimit dhe bazuar në raportin vjetor mbi mbledhjen e tarifave, financimi nga Buxheti i Kosovës sipas paragrafi 4. të nenit 21 të këtij ligji do të rishikohet dhe zvogëlohet për shumën e mbledhur përmes mekanizmit të abonimit.

4. Të gjitha ekonomitë familjare dhe subjektet juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik.

5. Ekonomitë familjare që janë shfrytëzuese të ndihmave sociale dhe invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve të UÇK, sipas ligjit në fuqi lirohen nga parapagimi për transmetuesin publik.

6. Me qëllim të verifikimit të numrit të këtyre familjeve Ministria përkatëse për punë dhe Mirëqenies Sociale në fund të çdo viti RTK i dërgon një regjistër me numrin e saktë të përfituesve të këtyre kategorive.

7. Të gjitha objektet religjioze në Republikën e Kosovës përjashtohen nga parapagimi.

8. Në ato vendbanime ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës në të cilat mungon sinjali me cilësi të pranueshme televizive të rrjetit tokësor, të lirohen nga pagesa e parapagimit televiziv deri në sigurimin e kushteve teknike për pranimin e programit të RTK-së.

9. RTK-ja është e autorizuar t'i sjell rastet e mos-përputhjes me kërkesën për parapagim para një gjykate me juridiksion kompetent, bazuar në dispozitat e ligjit të aplikueshëm, për qëllime të zbatimit të arkëtimit të parapagimit.

10. Gjykata kompetente obligohet që në rastet e mospagesës, respektivisht mospagesës së rregullt të parapagimit të RTK-së ti trajtojë me përparësi dhe urgjencë.

11. RTK, mban evidencë të saktë të gjendjes dhe ecurisë së parapagimit dhe të gjendjes së përgjithshme financiare të tij.

### **Neni 23 Financimi nga themeluesi**

Për sigurimin e bazave të veprimtarisë së pacenuar, aktiviteteve të rregullta dhe pavarësisë editoriale të RTK-së, si institucion i pavarur publik, themeluesi në varësi të mundësive buxhetore siguron mjete financiare.

## **KREU V ORGANET E RTK -së**

### **Neni 24 Organet drejtuese dhe të udhëheqjes të RTK-së**

1. Organet drejtuese dhe udhëheqëse të RTK-së janë:

1.1. Bordi i RTK-së;

1.2. Drejtori i Përgjithshëm.

### **Neni 25 Përbërja e Bordit**

1. Bordi i RTK-së është organ kolegjal-drejtues i RTK-së.

2. Bordi i RTK-së përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.

3. Anëtarët e bordit të RTK-së janë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, kinematografia, gazetaria, drejtësia, biznesi dhe menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, universiteti, media dhe teknikës.

4. Anëtarët e bordit duhet të jenë individë me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional dhe moral. Gjatë punës së tyre, anëtarët e bordit duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektiv dhe të paanshëm.

5. Anëtarët e Bordit emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë RTK-së përveç interesit të publikut. Ata nuk lejohet të kërkojnë apo pranojnë asnjë instruksion në lidhje me aktivitetet e Bordit nga asnjë interes jashtë RTK-së.

6. Përbërja e Bordit të RTK-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë të Bordit të RTK-së emërohen nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar emërohet nga komunitetet tjera jo shumicë dhe së paku dy (2) anëtarë të jenë të gjinisë femërore. Të paktën dy(2) anëtarë të Bordit do të kenë kualifikime profesionale në fushën e financimit, menaxhimit biznesor dhe të drejtësisë.

7. Anëtarët e Bordit duhet ti përmbahen ligjit të aplikueshëm në Kosovë dhe e kanë të ndaluar që të kërkojnë dhe pranojnë udhëzime gjatë përbushjes së detyrave të tyre prej cilitdo autoritet tjetër.

8. Anëtarëve të Bordit u ndalohet keqpërdorimi i pozitës së tyre për përfitim personal apo të familjes së tij të ngushtë, të ndonjë pale tjetër apo entiteti.

## **Neni 26** **Zgjedhja e anëtarëve të Bordit**

1. Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente.

2. Kandidatët për Bordin të RTK-së propozohen sipas procedurave të mëposhtme:

2.1. brenda nëntëdhjetë (90) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, RTK bënë shpallje publike brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj.

2.2. pesë (5) ditë pas mbylljes së shpalljes publike, të gjitha aplikacionet RTK ia dorëzon Kuvendit të Kosovës i cili themelon Komisionin ad – hoc për shqyrtimin e tyre.

2.3. brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë në Bord, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e RTK-së.

2.4. bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.

3. Mandati i anëtarëve të Bordit do të jetë si në vijim: Katër (4) anëtarë të Bordit të RTK-së do të emërohen me mandat dy (2) vjeçar, katër (4) anëtarë me mandat tre (3) vjeçar dhe tre (3) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar, dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së mandatit nga secili grup do të bëhet me short.

4. Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit të RTK-së është dy (2) vite, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

5. Anëtarët e Bordit, mund të ri-emërohen vetëm edhe për një mandat tjetër tre (3) vjeçar.

**Neni 27**  
**Pamundësia për të qenë anëtarë i Bordit**

1. Anëtar i Bordit të RTK-së nuk mund të jenë:

- 1.1. anëtarët e familjes së ngushtë të stafit menaxhues;
- 1.2. ish punonjësit të punësuar në RTK në dy (2) vitet e fundit;
- 1.3. personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar (funksionarët publik) apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
- 1.4. është anëtar i organit udhëheqës të një partie politike apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
- 1.5. është anëtar i organit udhëheqës të ndonjë ndërmarrje publike;
- 1.6. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy (2) vitet e fundit;
- 1.7. të mos jetë i dënuar për vepër penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;
- 1.8. pronarët apo bashkëpronarët e medieve transmetuese ose bizneseve reklamuese si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media;
- 1.9. është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit siç është përcaktuar me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

2. Anëtari i Bordit ose anëtari i ngushtë i familjes së tij nuk guxon të ushtroj veprimtari afariste me institucionin publik të RTK-së.

**Neni 28**  
**Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit**

1. Shkarkimi i anëtarit nga Bordi i RTK-së bëhet kur vërtetohet se ka ndonjë bazë për largim që parashihet me nën-paragrafët 3.3, 3.4 dhe 3.5 të paragrafit 3. të këtij neni dhe që mund të zbatohet për anëtarin.

2. Shkarkimi i një anëtari nga Bordi do të bëhet sipas procedurës në vijim:

- 2.1. propozimi për shkarkim vje nga Bordi i RTK-së me kërkesën e shumicës së thjeshtë të numrit të anëtarëve të Bordit ose të ndonjë iniciative tjetër nga jashtë sipas kushteve të përcaktuara nga paragrafi 3. i këtij neni.
- 2.2. Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të Bordit.

3. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit mund të bëhet sipas këtyre kushteve:

- 3.1. paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon ti përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit;
- 3.2. paaftësisë mentale apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit;

- 3.3. nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nenit 26 të këtij ligji.
  - 3.4.ka dështuar në realizimin e detyrave të tij/saj për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muajve pa aprovim nga Bordi;
  - 3.5. nëse anëtari është dënuar për veprë penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg;
  - 3.6.nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nën-paragrafëve 1.3, 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1. të nenit 27 të këtij ligji.
  - 3.7. mungesës në punë mbi një (1) muaj pa arsye;
  - 3.8. ka marrë pjesë aktive në aktivitete politike pasi që është emëruar si anëtar i Bordit.
4. Anëtarët e Bordit mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim Bordin të paktën tre (3) muaj përpara.

### **Neni 29** **Kompetencat e Bordit të RTK-së**

- 1. Bordi i RTK-së, punon dhe vepron në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të statutit të RTK-së.
- 2. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë:
  - 2.1. e aprovon statutin e RTK-së;
  - 2.2. e aprovon rregulloren e punës së bordit si dhe rregulloret tjera të përcaktuara me statut;
  - 2.3.shqyrton dhe miraton programet, bazat dhe standardet programore në përputhje me politikën programore, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të informimit publik sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;
  - 2.4.shqyrton dhe miraton projekt-programin e produksionit të RTK-së i cili duhet të jetë në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
  - 2.5.shqyrton dhe miraton skemën e përgjithshme programore;
  - 2.6.Emëron dhe shkarkon, Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së,
  - 2.7.emëron dhe shkarkon zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e Radiove dhe Televizioneve dhe udhëheqësin e shërbimeve të përbashkëta me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;
  - 2.8.miraton strukturën organizative dhe konceptin programor të RTK-së;
  - 2.9. e shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik i cili pas shqyrtimit në bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim;
  - 2.10.shqyrton dhe publikon më së largu deri më 31 mars të çdo viti raportin financiar vjetor të të hyrave dhe të shpenzimeve për vitin paraprak të përgatitur nga menaxhmenti i RTK-së i cili i nënshtrohet një auditimi të jashtëm të pavarur. Raporti në fjalë më pas i dërgohet Themeluesit për trajtim dhe veprim;



2.11. miraton plan programin vjetor, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj;

2.12. miraton kodin e mirësjelljes për RTK-në dhe siguron zbatimin efektiv të saj;

2.13. mbikëqyrë paanshmërinë, objektivitetin dhe saktësinë e informacionit në programin e RTK-së;

2.14. miraton kriteret kryesore profesionale për punësimin e personelit, politikave dhe procedurave të vlerësimit të përmbushjes së detyrave;

2.15. siguron që janë ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij ose KPM-së se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme;

2.16. vendos edhe për çështje të tjera të rëndësishme në përputhje me autorizimet dhe kompetencat që ka me ligj dhe statut;

### **Neni 30**

#### **Veprimtaria dhe mënyra e punës së Bordit të RTK-së**

1. Anëtari më i vjetër i Bordit të ri të RTK-së e konvokon mbledhjen e parë të Bordit të RTK-së sa më parë që është e mundur, e më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e emërimit të anëtarëve të Bordit.

2. Bordi i RTK-së konsiderohet se është konstituuar nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit.

3. Kryetari i Bordit të RTK-së, të paktën një herë në muaj, thërret mbledhjet e rregullta të këtij Bordi. Mbledhjet e Bordit të RTK-së mund të konvokohen edhe me kërkesën e së paku pesë (5) anëtarëve të Bordit. Sipas nevojës mbledhjet e Bordit mund të konvokohen edhe më shpesh.

4. Kuorumi i mbledhjeve të Bordit të RTK-së është gjashtë (6) anëtarë.

5. Mbledhjet e Bordit i udhëheqë kryetari në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës të Bordit të RTK-së.

6. Në mungesë të kryetarit të Bordit, mbledhjet i udhëheqë nënkryetari i tij.

7. Gjatë procesit të punës dhe vendimmarrjes, në Bordin e RTK-së, votimi është i hapur.

8. Bordi i RTK-së sipas këtij ligji është i detyruar që për punën e vet të raportoj, themeluesit të tij, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme.

9. Raportimi i rregullt i bordit për punën e tij, bëhet në mënyrë periodike – njëherë në çdo tre (3) muaj dhe në fund të çdo viti. Raportimi i jashtëzakonshëm, bëhet sipas kërkesës së themeluesit.

10. Procedurat tjera për punën e bordit përcaktohen me rregulloren e punës së bordit.

11. Në mbledhjen e parë Bordi i RTK-së, me shumicë të thjeshtë votash, zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij nga radha e anëtarëve të Bordit; nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit.

12. Votimi për zgjedhjen e kryetarit të bordit, bëhet me vota të fshehta.

13. Jo më shumë se dy (2) herë, anëtarët e bordit, mund të propozojnë dhe votojnë kandidatin e njëjtë për kryetar dhe /ose nënkryetar të bordit.

14. Kushtet, kriteret dhe procedurat e mëtejme për punën e Bordit, rregullohen me statut të RTK-së dhe me rregulloren e punës së bordit.

15. Drejtori i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Bordit të RTK-ës si anëtarë pa të drejtë vote.

### **Neni 31**

#### **Kushtet për emërim dhe shkarkim të menaxhmentit të RTK-së**

1. Asnjë person nuk mund të emërohet anëtarë i menaxhmentit të lartë, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, zëvendës drejtorin e përgjithshëm, drejtorët e radiove dhe televizioneve nëse ai:

1.1. mban post publik të zgjedhur (funksionarët publik);

1.2. ka qenë deputet, ministër, zyrtarë i lartë i pushtetit qendror apo lokal, apo anëtarë i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë tri (3) viteve të fundit;

1.3. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose indirekt në biznesin e medieve dhe reklamave ose

1.4. është dënuar pas procesit të rregullt, për veprë penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg;.

2. Anëtarë i menaxhmentit të lartë të RTK-së nga paragrafi 1. i këtij neni, mund të shkarkohet në rast së:

2.1. e humb të drejtën sipas kushteve të paragrafit 1. të këtij neni;

2.2. dështon në kryerjen e punëve të tij në mënyrë efektive dhe

2.3. vepron në kundërshtim me këtë ligj ose ligjet e marrëdhënies së punës.

### **Neni 32**

#### **Kushtet për emërim dhe shkarkim të Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së e emëron Bordi i RTK-së në bazë të ligjit e sipas procedurave të caktuara, të parapara me konkurs publik.

2. Drejtori i Përgjithshëm duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe person me përvojë të menaxhimit të medieve apo fushave tjera relevante.

3. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-se emërohet dhe shkarkohet me 2/3 e votave të anëtarëve të Bordit. Mandati i tij do të jetë tri (3) vjet me mundësi të rizgjedhjes në bazë të konkursit, vetëm edhe për një mandat pasues.

### **Neni 33**

#### **Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së ka këto kompetenca, përgjegjësi dhe detyra:

1.1. menaxhon veprimtarinë e RTK-së në pajtim me këtë ligj dhe me statutin e RTK- si dhe me Kodin Etik të RTK- së;

1.2. zgjedh dhe shkarkon personelin e RTK-së, në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, Ligjin e RTK-së dhe Statutin e RTK-së;

1.3. merr vendim lidhur me çështjet e organizimit, financave dhe pagave, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Bordi i RTK-së;

1.4. e përfaqëson RTK-në brenda dhe jashtë vendit;

1.5. bashkërendon punën e njësive administrative të sistemit të RTK-ës dhe zgjidh, brenda kompetencave të tij, mosmarrëveshjet midis tyre; Drejtori i Përgjithshëm i RTK-se i raporton Bordit se paku një herë në muaj;

1.6. përgatit dhe i paraqet Bordit një plan program vjetor i cili është në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj;

1.7. ndërmer masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme,

1.8. kryen punë tjera të përcaktuara me Statutin e RTK-së.

#### **Neni 34**

#### **Zëvendës drejtori i përgjithshëm i RTK-së**

1. Zëvendës drejtori(ët) e përgjithshëm i zgjedh Bordi i RTK-së në bazë të konkursit publik dhe sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm. Zv/drejtorët e përgjithshëm e ndihmojnë dhe zëvendësojnë Drejtorin e Përgjithshëm në udhëheqjen e RTK-së.

2. Në bazë të propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, Bordi vendos për numrin e së paku një (1) zëvendës drejtori dhe jo më shumë së dy (2).

3. Zëvendës drejtori(ët) e përgjithshëm kryen edhe punë tjera të përcaktuara me Statutin e RTK-së.

#### **Neni 35**

#### **Zgjedhja e menaxhmentit të RTK-së**

1. Bordi i RTK-së e zgjedh Drejtorin e Kanalit Televiziv në gjuhën shqipe, Drejtorin e Radios dhe Udhëheqësin e Shërbimeve të Përbashkëta në bazë të kualifikimeve profesionale pas procesit të hapur dhe transparent të punësimit dhe duke marrë në konsiderim rekomandimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

1.1. Bordi i RTK-së e zgjedh Drejtorin e Kanalit Televiziv në gjuhën serbe në bazë të kualifikimeve profesionale pas procesit të hapur dhe transparent të punësimit dhe duke marrë në konsiderim rekomandimin e Grupit Punues për Përzgjedhjen e Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe.

1.2. për qëllimin e punësimit të Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe, Bordi i RTK-së themelon një Grup Punues të përbërë nga:

1.2.1. shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë të gjithë politikisht të pavarur dhe përfaqësues të shoqërisë civile ose ekspertë në media;

1.2.2. katër (4) janë pjesëtarë të komunitetit serb;

1.2.3. dy (2) janë pjesëtarë të komunitetit shqiptar; dhe

1.2.4. një (1) është pjesëtar i një komuniteti tjetër jo-shumicë, përveç komunitetit serb.

1.3. Grupi Punues për Përzgjedhjen e Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe propozon së paku dy (2) kandidatë për Drejtor të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe, të cilët i plotësojnë kriteret minimale profesionale të përcaktuara në rregullore. Grupi Punues mund t'i radhisë kandidatët sipas preferencës. Bordi i RTK-së më pas mund të emërojë një kandidat nga lista brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i saj. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk është i pranueshëm për Bordin e RTK-së, Kryetari i Bordit i dërgon Grupit Punues një kërkesë me shkrim për një listë të dytë të kandidatëve të mundshëm shtesë. Grupi Punues brenda tridhjetë (30) ditëve i dërgon Bordit listën e dytë me së paku dy (2) kandidatë të cilët nuk ishin në listën e parë dhe të cilët i përmbushin kriteret minimale profesionale. Bordi i RTK-së më pas emëron njërin nga kandidatët e listës së dytë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i saj.

1.3.1. në rast se Grupi Punues nuk e dërgon listën e dytë të kandidatëve brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i kërkesës me shkrim të Bordit të RTK-së, Bordi do të emërojë Drejtorin e Kanalit Televiziv në gjuhën serbe nga një listë e kandidatëve të mundshëm që i plotësojnë të gjitha kriteret minimale profesionale.

2. Drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i radios dhe udhëheqësi i shërbimeve të përbashkëta për punën e tyre i përgjigjen Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv/drejtorëve të përgjithshëm.

3. Drejtori i programit nga paragrafi i mësipërm nuk mund të jetë njëkohësisht udhëheqës i shërbimeve të përbashkëta.

4. Drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i radios e udhëheqë pjesën profesionale të programit të institucionit dhe e harmonizon punën e kryeredaktorit.

5. Secili Kryeredaktor i RTK-së zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së në bazë të konkursit publik dhe sipas rekomandimit të drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtorit të radios. Kryeredaktori të mos jetë tri (3) vitet e fundit në organet e larta udhëheqëse politike.

6. Kryeredaktori i RTK-së shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Statut.

7. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-se i raporton Bordit në mënyrë të detajuar lidhur me procedurat dhe mënyrën e emërimit të Kryeredaktorit.

8. Me rekomandimin e kryeredaktorit, redaktorin përgjegjës dhe redaktorin e njësisë përkatëse programore e zgjedh dhe shkarkon drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i radios, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë ligj dhe statutin e RTK-së.

9. Drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i radios dhe udhëheqësi i shërbimeve të përbashkëta zgjedhën për tri (3) vite me mundësi të rizgjedhjes.

### **Neni 36 Grupi Këshillues i Publikut**

1. Bordi i RTK-së e emëron Grupin Këshillues të Publikut.

2. Përbërja e Grupit Këshillues të Publikut rregullohet me Statutin e RTK-se .

3. Grupi Këshillues i Publikut shqyrton:

3.1. vërejtjet dhe sugjerimet e shikuesve dhe dëgjuesve;

3.2. i këshillon Bordin e RTK-së që të shqyrtohen çështjet e caktuara lidhur me programet e RTK-së si dhe

3.3. kryen punë të tjera të caktuara me Statut.

4. Procedurat e emërimit dhe ndryshimit të anëtarëve të Grupit Këshillues të Publikut do të rregullohen me Statut të RTK-së.

### **Neni 37**

#### **Mbikëqyrja e funksionimit të RTK-së**

1. Mbikëqyrja e veprimtarisë së RTK-së kryhet nga organet e autorizuar për një gjë të tillë nga ligji dhe Statuti.

2. Një trup i auditorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e rregullsisë dhe përputhshmërisë së veprimeve dhe auditimit e akteve për veprimet dhe akteve për veprimet e planifikuara të RTK-së në kuadër të kornizës së kompetencave që i ushtron mbi subjektet që kryejnë veprimtari publike.

3. Përveç personave të autorizuar për të kërkuar përgjegjësi në emër të anëtarëve të organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të përcaktuara nga ligji, Kuvendi i Kosovës gjithashtu është i autorizuar të kërkojë një përgjegjësi të tillë.

4. Bordi i RTK-së e merr një raport auditimi nga një ekspert i pavarur i auditimit për çdo vit deri më 1 qershor. Ekspert i auditimit nuk mund të jetë një person i cili, gjatë dy (2) viteve para marrjes së detyrës nga Drejtori i Përgjithshëm ose nga Bordi i RTK-së, ka bashkëpunuar në çfarëdo mënyre në cilësi komerciale me RTK-në ose me subjektet e lidhura me të. RTK-ja dhe subjektet e lidhura me të nuk mund të bashkëpunojnë në cilësi komerciale me ekspertin e përzgjedhur të auditimit për dy (2) vite pas dorëzimit të raportit të auditimit.

### **Neni 38**

#### **Karakteret publik i veprimtarisë**

1. Veprimtaria e RTK-së do të jetë publike. Raporti Vjetor duhet të publikohet në mënyrën e përcaktuar me Statut. Raporti vjetor duhet të përmbajë një ndarje të shpenzimeve të ofrimit të shërbimeve, përmbajtjes ose kanaleve nga grupet individuale apo përmbajtjes programore dhe të raportit të Bordit të RTK-së.

2. Raporti vjetor duhet të publikohet në faqen e internetit të RTK-së.

3. RTK-ja, një herë në vit, organizon një debat publik mbi përmbajtjen e raportit vjetor dhe përpilon një raport mbi debatin, i cili do t'ia dorëzojë Bordit të RTK-së.

4. RTK do t'ia dërgojë raportin vjetor, raportin mbi debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së në raportin e debatit publik për qëllime orientuese, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**KREU VI**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 39**  
**Statuti i RTK-së**

1. Me Statutin e RTK-së, në veçanti përcaktohet: organizimi i institucionit publik, statusi dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve të RTK-së, organet, autorizimet dhe përgjegjësitë e tyre, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e menaxhmentit dhe personelit të RTK-së, procedurat e menaxhimit financiar si dhe çështjet tjera të rëndësishme për ushtrimin e veprimtarisë dhe afarizmit të institucionit.

2. RTK, ka edhe akte të tjera juridike.

3. Statuti i RTK-së hynë në fuqi në ditën e shpalljes, ndërsa aktet e tjera në kohën dhe mënyrën e caktuar me Statutin e RTK-së.

**Neni 40**  
**Vazhdimësia e RTK-së**

1. Që nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji RTK vazhdon të ushtrojë veprimtarinë e vetë me autorizime të përcaktuara me ligj.

2. Me fillimin e zbatimit të këtij ligji, bordi aktual dhe menaxhmenti aktual i RTK-së do të vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e përcaktuara nga ky ligj deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj sipas këtij ligji.

3. Programet e RTK-së duhet të arrijnë përputhshmëri të plotë me dispozitat e këtij ligji sa më shpejt që është e mundur por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Statuti i RTK-së duhet të miratohet, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 41**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 02/L-47 për RTK-në i shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 34 (01.08.2008) si dhe shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

**Neni 42**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-46**  
**29 mars 2012**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-012-2012, datë 12.04.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.**